

HASAN BELLO

**REFORMA ARSIMORE E VITIT 1933: MBYLLJA E
SHKOLLAVE PRIVATE DHE ACARIMI I RAPORTEVE
ME KLERIN KATOLIK DHE VATIKANIN**

Një konflikt i ri mes qeverisë shqiptare, klerit katolik dhe Vatikanit filloi kur Mbreti Zog mori një varg masash, të cilat, ripohonin linjën e pavarësisë dhe ishin në të njëjtën kohë një kundërvënie ndaj diktatit italian. Në shtypin e kohës shpërtheu një fushatë kundër shkollave private, duke kërkuar që ato të organizoheshin dhe të drejtoheshin vetëm nga shteti. Sipas këtyre shkrimeve shkolla e shtetit duhej të ishte e vetmja vatër e formimit të njëtrajtshëm kombëtar të brezave, ku do të qëndronin pranë e pranë fëmijë të të gjithë shtresave dhe besimeve. Ndërsa shkollat e huaja shikoheshin si përçuese të influencave të shteteve fqinjë dhe si një rrezik për unitetin kombëtar.¹ Sipas një raporti të hartuar nga Ministria e Arsimit konsekuenca e kësaj gjendjeje tek këto shkolla dalëngadalë ishte veshur me një autoritet të pavarur me të cilin justifikoheshin për zbatimin e programit dhe të sistemeve antipedagogjike shpesh në kundërshtim me ato të shkollës shtetërore si dhe me ndihma të huaja.² Më 10 prill 1933, një grup deputetësh i paraqitën Parlamentit një mocion për ndryshimin e disa neneve të Statutit Themeltar midis të cilëve edhe dy neneve që kishin të bënin me shtetëzimin e shkollave private dhe monopolizimin e arsimit nga shteti.³ Në mbledhjen e 10 dhe 11 prillit 1933, Parlamenti ndryshoi nenin 206 të Kushtetutës, sipas të cilit, mësimi dhe edukimi i shtetasve shqiptarë do të ishte një e drejtë ekskluzive e shtetit. Ai jepej vetëm ndër shkollat dhe institutet shtetërore sipas ligjit, arsimit fillor për të gjithë shtetasit shqiptarë bëhej i detyrueshëm dhe jepej falas. Shkollat private, të çdo kategorie, që kishin vepruar deri në këtë

¹ *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2003, f. 429.

² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), fondi (më tej: F.) 295, viti (më tej: V.) 1934, dosja (më tej: D.) 4, fl. 3. Raport mbi aktivitetin e zhvilluar nga Ministria e Arsimit gjatë viteve 1932-33-34.

³ *The National Archives*, London (më tej: *TNA*), Foreign Office (më tej: FO) 371/16625. Raport i legatës britanike në Durrës për FO, 19.4.1933.

periudhë mbylleshin.⁴ Në relacionin e Parlamentit lidhur me ndryshimin e nenit 206 shkruhej se shkollat private nuk kishin përmbushur kondita të tilla si: që burimi i mjeteve të tyre të ishte i siguruar dhe i pajtueshëm me qëllimin e shkollës shtetërore; që personeli edukues të ishte i zgjedhur prej çdo ndjesie që ishte në kundërshtim me kriteret e shtetit dhe me parimet e edukatës kombëtare, që brezi i ri duhet të zbatonte; që të ndihmonin shtetin, duke hapur shkolla në ato vende në të cilat ai nuk kishte mundësi t'i hapte vetë.⁵

Por, sipas relacionit, e shumta e tyre i nxirrte mjetet e ekzistencës nga burimet e huaja, të dhëna për qëllime aspak të mira. Personeli edukues ose ishte i frymëzuar nga përfitimi financiar, ose ishte i huaj dhe i nënshtruar nga pikëpamja e mendimit dhe mënyrës së edukimit një autoriteti tjetër dhe jo ndaj shtetit shqiptar. Këto shkolla, ishin hapur në vende në të cilat nuk ndjehej nevoja e tyre, sepse kishte shkolla shtetërore të po asaj kategorie. Qëllimi i tyre, në shumicën e rasteve, mbështetej ose mbi spekulimet politiko-fetare, ose mbi ato financiare, ose te të dyja së bashku. Duke ia përshtatur veprimtarinë e tyre këtyre qëllimeve, ato shkaktonin përçarje në popull dhe rinisë i jepnin një edukatë që nuk ishte në përputhje me interesat e larta të kombit.⁶ Ndërsa, sipas nenit 207, shkollat fetare për përgatitjen e klerit shqiptar ishin të lira dhe rregulloheshin me ligj.⁷ Ndryshimet në Statut u pranuan unanimisht prej Parlamentit dhe më 22 prill 1933 u dekretuan nga Mbreti Zog. Miratimi i tyre i hapi rrugën Ministrisë së Arsimit për të marrë nën kontroll të plotë institucionet private, duke përfshirë edhe ato të cilat drejtoheshin nga kleri katolik.⁸ Një shkollë italiane, e cila ushtronte aktivitetin e saj nën mbikëqyrjen e konsullatës italiane në Vlorë u mbyll para se autoritetet shqiptare ta merrnin nën kontroll.⁹

⁴ *AQSH*, F. 295, V. 1934, D. 4, fl. 4. Raport mbi aktivitetin e zhvilluar nga Ministria e Arsimit gjatë viteve 1932-33-34.

⁵ *Po aty*.

⁶ *Po aty*.

⁷ “Ndryshohen nenet e statutit që bëjnë fjalë mbi arsimin. (Arsimi fillor i detyrueshëm. Edukimi i shtetasve do të bëhet vetëm nga shkollat e shtetit). Mocioni i aprovuar nga Parlamenti”, në *Gazeta e Korçës*, nr. 1648, Korçë, 12.4.1933, f. 1.

⁸ “Lajme shkodrane (Kronikë, 25 prill). Njoftim mbi mbylljen e shkollave fetare në qytetin e Shkodrës”, në *Leka*, nr. 5, Shkodër, maj 1933, f. 166.

⁹ *TNA*, FO 371/16625. Raport i Sër R. Hodgson për FO, 19.4.1933.

Kjo nismë gjeti miratimin e intelektualëve, mësuesve dhe shtypit të kohës.¹⁰ Ndërsa kleri dhe kisha katolike e kishin shprehur me kohë qëndrimin e tyre.¹¹ Prandaj ata e konsideruan këtë reformë si një sulm të drejtpërdrejtë që i bëhej katolicizmit. Më 30 prill 1933, klerikët i drejtuan qeverisë një memorandum ku shprehej shqetësimi se ligji për mbylljen e shkollave private kishte tronditur thellë ndërgjegjen e katolikëve shqiptarë. Në memorandum shtjellohej se e drejta dhe obligimi i edukimit i përkiste prindërve dhe jo shtetit; se vetëm shteti sovjetik kishte adaptuar parimin tashmë të ndjekur nga qeveria shqiptare; prandaj për të qenë logjike ajo duhej të adaptonte gjithashtu të gjitha parimet e tjera të teorisë komuniste; se në të gjitha vendet e qytetëruara shkollat private ishin të lejuara. Shqipëria, duke i ndaluar ato, ishte vënë në të njëjtën lartësi me BRSS dhe kishte kryer një akt kundër qytetërimit dhe lirisë individuale; se prej 20 shekujsh ata ishin katolikë dhe shqiptarë dhe se kishin qenë përherë në linjë të parë për të mbështetur pavarësinë dhe unitetin kombëtar. Shkollat katolike, prej 70 vjetësh e më tepër, kishin qenë vatra e vërtetë e propagandës kombëtariste dhe qendra e vetme kulturore shqiptare. Katolikët kishin kontribuar me efektshmëri për formimin e Shqipërisë së pavarur. Prandaj, sipas klerit katolik, ishte shumë e çuditshme që gjendej një pretekst se shkollat katolike ishin të frymëzuara nga jashtë dhe ndiqnin synime të kundërta me unitetin e Shqipërisë.¹²

Sipas tyre: një veprim i tillë nuk kishte ndodhur në asnjë vend të botës, me përjashtim të Rusisë; ligji privonte të drejtën e prindërve për edukimin e fëmijëve, duke njohur superioritetin e shtetit; ky veprim i hapte rrugën penetrimit të ideologjisë bolshevike, e cila kishte filluar të ndjehej ndjeshëm në qytetet shqiptare; ai cenonte të drejtën e kishës për

¹⁰ “Gostia e arsimtarëve të Korçës me rastin e vendimit për shtetëzimin e shkollave. Edhe tekstet e telegrameve dërguar Mbretit, Parlamentit dhe Ministrisë së Arsimit”, në *Gazeta e Korçës*, nr. 1658, Korçë, 28.4.1933, f.4; Nebil Çika, “Një e kthyer e historisë. Shtetëzimi i shkollave”, në *Minerva*, nr.12-13, Tiranë, korrik-gusht 1933, f. 1-2.

¹¹ “Letër enciklike e shenjtit atë Papë Pio XI përmi edukatën e krishtenë të moshës së re. Edukimi i brezit të ri i përket kishës, familjes, shtetit, por mbi të gjitha kishës edhe në rast se normat e tyre nuk përputhen me dogmat e saj”, *Lajmëtari i zemrës së Jezu Krishtit*, nr. 2, Shkodër, shkurt 1930, f. 18-21.

¹² *Archivio Storico Diplomatico di Ministero degli Affari Esteri*, Roma (më tej: *AMAE*), Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 32, fasc.13. Telekspres i legatës italiane në Tiranë për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Tiranë, 5.5.1933.

edukimin e fëmijëve katolikë; veprimtaria e këtyre shkollave, sipas klerikëve, nuk ishte ndërprerë nga asnjë pushtues i huaj. Prandaj, mbylljen e tyre ata e konsideronin si një akt të paprecedentë në historinë e popullit shqiptar; me kontributin e tyre arsimor shkollat katolike kishin luftuar analfabetizmin, kishin zbutur egërsinë zakonore, kishin zhvilluar artin, gjuhën dhe letërsinë shqiptare; shkollat klerikale ishin përfaqësuesi më ekselent i kulturës oksidentale.

Arsyetimin e miratimit të këtij ligji në Parlament se nëpër shkollat private përhapej ndasia kombëtare, klerikët e hidhnin poshtë me fjalët: “*Na ktu në Shqypni gjindemi tash dy mijë vjet e nuk e dijmë se gjatë njëzet shekujve jemi da e përça prej kujë. Katolikë atëherë, katolikë sod; shqyptarë atëherë, shqyptarë sod, sod e përgjithmonë*”. Sipas tyre, elementi katolik kishte dëshmuar gjatë historisë se ishte kontribuues i rëndësishëm i lëvizjes për pavarësi kombëtare.¹³

Autoritetet italiane mbylljen e shkollave katolike e konsideruan si një akt aspak miqësor.¹⁴ Ato e kuptuan se në radhë të parë këto masa kishin si qëllim pengimin e influencës italiane, depërtimi i së cilës kishte marrë përmasa shqetësuese për stabilitetin politik të shtetit shqiptar.

Mbyllja e shkollave katolike, krahas protestave drejtuar qeverisë dhe Parlamentit, u shoqërua dhe me një pastorale të brendshme të ipeshkvijve. Në këtë pastorale shtjelloheshin arsyet për të cilat edukimi i rinisë i përkiste prindërve dhe kishës. Ndër të tjera kërkohej: ngritja në Shqipëri e një organizate të tipit të “Aksionit Katolik”, siç ekzistonin në vende të ndryshme katolike; shkishërim kundër atyre që votonin dhe propozonin ligje në kundërshtim me kishën; kërcënime të drejtpërdrejta kundër qeveritarëve; nënshkrimi i Konkordatit me Selinë e Shenjtë; ngritja e kurseve të katekizmit, për të ruajtur kontrollin e rinisë dhe për të mbajtur të gjallë besimin katolik.¹⁵

Më 24 maj 1933, delegati apostolik, Della Pietra mbërriti në Vatikan për të diskutuar me Sekretarin e Shtetit Kardinal Pacelli-n dhe me Atin e

¹³ “Memorandum. Drejtuar qeverisë nga arkipeshkvi dhe ipeshkvi të Shqipërisë lidhur me ligjin për mbylljen e shkollave private dhe fetare”, në *Fletorja e klerit katolik të Shqypnis*, numër i veçantë, Shkodër, maj 1933, f. 3-7.

¹⁴ TNA, FO 371/13562. Raport i Sër R. Hodgson nga Durrësi për Sër John Simon, 3.5.1933.

¹⁵ AMAE, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 32, fasc.13. Telekspres i legatës italiane në Tiranë për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Tiranë, 6.5.1933.

Shenjtë situatën e krijuar pas mbylljes së shkollave katolike. Ndërsa organi zyrtar i Vatikanit *L'Orsservatore Romano* vazhdoi të heshte për këtë problem me gjithë ndjeshmërinë që ajo kishte shfaqur në raste analoge.¹⁶ Kjo tregon se autoritetet drejtuese ishin duke pritur se deri ku do të shtrihej kjo reformë.

Della Pietra u thirr në Vatikan për të sqaruar gojarisht situatën e katolikëve dhe të klerit në Shqipëri. Ai mori me vete në Romë një memorandum të nënshkruar nga ipeshkvijtë, në të cilin i paraqitej Lidhjes së Kombeve, gjendja kritike e katolikëve të Shqipërisë. Memorandumi kishte qenë objekt diskutimi nga ana e ipeshkvijve të mbledhur në Shkodër, një pjesë e të cilëve ishte e mendimit t'ia paraqisnin edhe qeverisë italiane. Ndërsa argjipeshkvi i Durrësit, imzot Gjura, nuk kishte pranuar të theksohej varësia e katolikëve nga një shtet i huaj për shkak të përshtypjes së keqe që do të shkaktonte tek zyrtarët e Tiranës, të cilët, sipas tij, mund të gjenin pretekstin për përndjekje të reja. Legata italiane në Tiranë bëri përpjekje ta ndalonte paraqitjen e një memorandumit të tillë.¹⁷ Ajo i trembej faktit se ky veprim do ta acaronte akoma dhe më shumë situatën.

Pas memorandumit drejtuar qeverisë, Këshilli i Ipeshkvijve mori vendim, që në të gjitha famullitë e vendit të bëhej leximi publik i pastorales. Kjo shkaktoi, në disa famulli, komente kritike ndaj qeverisë. Prandaj, kjo e fundit shqyrtoi në një mbledhje urgjente këtë ofensivë të re të klerit, me qëllimin që të merrte masat e nevojshme. Pjesë e qeverisë ishin edhe dy ministra katolikë, ministri i Arsimit Mirash Ivanaj, që kishte marrë mbi vete të gjithë përgjegjësinë e reformës, dhe shkodrani Sandër Saraçi, ministër i Punëve Publike, të cilin Mbreti kishte preferuar të mos e bënte pjesë të mbledhjeve që kishte shqyrtuar çështjen. Kjo për shkak se pastoralja parashikonte shkishërimin e katolikëve përgjegjës për masat kundër të drejtave dhe lirisë së kishës. Prandaj, ai mund të gjendej në kushte mjaft delikate, duke marrë pjesë në vendime armiqësore ndaj ipeshkvijve që e kishin nënshkruar.

¹⁶ Costantinus, "Rreth memorandumit të Ipeshkvive katolik shqiptar (Delegati Apostolik i Shqipërisë Imzot Dela Pietra në Vatikan)", në *Shqipëria e re*, nr. 532, Kostancë, 15.6.1933, f. 2.

¹⁷ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 32, fasc.13. Telekspres i legatës italiane në Tiranë për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Tiranë, 10.6.1933.

Qeveria shqiptare vendosi të ndiqte një politikë të matur përballë manifestimeve të tilla. Megjithatë ajo ishte e vendosur për ta çuar deri në fund këtë reformë. Ajo i bëri me dije argjipeshkvit të Shkodrës dhe prej tij ipeshkvijve të tjerë, se në rast se do të manifestohej ndonjë gjest tjetër kritik, kundrejt tyre do të merreshin sanksione të rënda.¹⁸

Autoritetet shqiptare nuk morën asnjë masë represive kundër ipeshkvijve dhe famullitarëve që nënshkruan dhe lexuan pastoralen mbi mbylljen e shkollave katolike në Shqipëri. Megjithatë ipeshkvijtë u thirrën nga prefekti i Shkodrës dhe famullitarë të ndryshëm nga prefektët përkatës, dhe iu hoq vërejtja për të mos u marrë me politikë; të mos nxisnin popullin me fjalime apo lexime; të mos shfrytëzonin besimin për qëllime politike, duke i kërcënuar me sanksione të ashpra në rast se ata do të shkelnin këto vërejtje. Këto veprime shkaktuan një farë frike në radhët e klerit. Ipeshkvijtë i drejtuan një letër ministrit të Brendshëm, Musa Jukës, ku i shkruanin se më 19 qershor ishin thirrur në prefekturën e Shkodrës, titullari i së cilës, i autorizuar nga qeveria, i kishte tërhequr vërejtjen se me publikimin e pastorales, kishin dhunuar ligjet dhe kishin nxitur popullin duke hapur një fushatë politiko-fetare dhe merituar ndëshkimet e përcaktuara nga ligji. Por se qeveria, nga respekti i madh që kishte për Episkopatin, kishte urdhëruar t'u tërhiqej vëmendja dhe t'u kërkohet siguri formale që ipeshkvijtë nuk do ta përsërisnin më këtë veprim. Kleri përpigjej të justifikohet duke ia veshur të gjithë përgjegjësinë doktrinës fetare. Ipeshkvijtë, shkruanin se detyra e shtynte klerin të dilte kundër vullnetit të qeverisë, dhe se pastoralen, edhe nëse dhunoheshin ligjet e shtetit, e kishin bërë vetëm prej nevojës në të cilën ishin gjendur. Ky veprim, sipas tyre, mbështetej edhe në Statutin Themeltar, i cili siguronte lirinë e besimit. Ata protestonin për pohimin e bërë nga prefekti se kleri po e përdorte besimin për qëllime politike. Sipas ipeshkvijve, sjellja e tyre ishte frymëzuar nga parimet e vetë besimit, i cili e vendoste Zotin mbi shtetin e për rrjedhojë ligjet e Zotit mbi ato të shtetit; se kur mes këtyre dy kategorive ligjesh kishte kundërshti, ata nuk mund të shkelnin ligjet e Zotit.¹⁹

¹⁸ AMAE, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 32, fasc.13. Telekspres i legatës italiane në Tiranë për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Tiranë, 17.6.1933.

¹⁹ AMAE, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 32, fasc.13. Telekspres i legatës italiane në Tiranë për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Tiranë, 26.6.1933.

Më 11 korrik, ipeshkvijtë i drejtuan të gjitha kishave, meshtarëve dhe popullit katolik një letër baritore ku sqarohet filozofia e kishës katolike lidhur me edukimin e rinisë, duke bërë thirrje të refuzonin frekuentimin e shkollave shtetërore.²⁰ Këto veprime e thelluan akoma më shumë hendekun e mosmarrëveshjeve me qeverinë. Megjithatë nga kjo e fundit nuk pati veprime represive. Ajo u përpoq me metoda të tërthorta për ta bindur klerin që të hiqte dorë nga kjo rrugë. Kështu, më 14 shtator, delegati apostolik, Della Pietra u thirr në Tiranë nga kreu i Zyrës Sekrete të Ministrisë së Brendshme, Spiridon Kacarosi, i cili zhvilloi me të një bisedë të gjatë në strehën famullitare të kryeqytetit. Ai i përmendi delegatit arsyet për të cilat qeveria shqiptare nuk mund të rihapte shkollat fetare, siç ishte uniteti i popullit, pavarësia, etj. Ndërsa Della Pietra i kujtoi gjithashtu se detyrë e klerit ishte të pengonte lëvizjet dhe trazirat në popull. Kacarosi i tërhoqi vëmendjen Della Pietras mbi dëshirën e qeverisë për t'i dhënë fund çdo rezistence nga ana e klerit, përndryshe “do të përgatitej një goditje edhe më e fortë”. Sipas legatës italiane me një shprehje të tillë Kacarosi ndoshta kishte dashur të aludonte për dëbimin e jezuitëve për të cilën prej njëfarë kohe ishte duke u folur në qarqet myslimane.²¹

Në faqet e shtypit shpërtheu një polemikë e ashpër mes përkrahësve të reformës arsimore²² dhe klerikëve katolikë, të cilët mbronin pikëpamjen e tyre duke i konsideruar veprimet e qeverisë si shkelje e të drejtave themelore.²³ Në funksion të kësaj kauze ata merrnin si shembull politikën arsimore të shteteve të përparuara si Anglia, Gjermania, SHBA,

²⁰ “Letër baritore e Ypeshkvijvet të Shqypnis meshtarëve dhe popullit katolik”, në *Shqipëria e re*, nr. 534, Kostancë, 16.7.1933, f. 2.

²¹ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 32, fasc. 13. Telekspres i legatës italiane në Tiranë për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Tiranë, 16.9.1933.

²² “Ç`presim prej arësimit. Arsimi në Shqipëri duhet të përgatisë njerëz aktivë dhe me mentalitet të ri, midis të cilëve edhe nëpunësit e shtetit”, në *Besa*, nr. 777, Tiranë, 14.2.1934, f. 1.

²³ “Letër e hapun. Redaksia e revistës “Hylli i Dritës” i përgjigjet Gjergj Bubanit, drejtor i gazetës “Kuvendi kombëtar” rreth urdhërit të Mirash Ivanajt për mbylljen e shkollave fetare, të huaja e private”, në *Hylli i Dritës*, nr. 2, Shkodër, shkurt 1934, f. 57-67.

Franca, Holanda, Belgjika dhe Brazili,²⁴ ku institucionet arsimore klerikale gëzonin hapësirat e nevojshme.

Argjipeshkvi dhe ipeshkvijtë katolikë i drejtuan Lidhjes së Kombeve (LK) një peticion.²⁵ Aty protestohet ndaj vendimit të shtetit shqiptar për mbylljen e shkollave private.²⁶ Peticioni mbështetet në deklaratën mbi mbrojtjen e pakicave që qeveria shqiptare kishte nënshkruar në vitin 1921 me LK.²⁷ Ipeshkvijtë mbronin tezën se katolikët shqiptarë përbënin një pakicë të denjë për tutelë në përputhje me deklaratën e mësipërme, e cila do t'u lejonte të kishin të drejtë të ruanin kulturën e tyre me anë të shkollave.²⁸ Por komiteti i minoriteteve në Gjenevë vendosi që për këtë të kërkonte sqarime nga qeveria shqiptare.²⁹

Në vizitën që zhvilloi në Itali, Della Pietra u takua me drejtuesit e Zyrës për Shqipërinë në MPJ të cilëve i konfirmoi mirënjohjen e katolikëve shqiptarë për qëndrimin e mbajtur nga qeveria italiane në çështjen e shkollave fetare dhe pyeti për zërat që ishin përhapur në Shqipëri rreth një marrëveshjeje të afërt mes qeverisë italiane dhe asaj shqiptare e cila nuk do të merrte parasysh rihapjen e shkollave katolike. Kjo u përgënjeshtroi nga zyrtarët italianë, të cilët kërkuan që elementi katolik të kishte besim të plotë tek qeveria italiane. Megjithatë, Della Pietra shtoi se në rast se Italia do të cedonte mbi çështjen e shkollave, prestigji i saj tek popullsia katolike do të kompromentohej. Si shembull solli rastin e Austrisë, e cila, me mbrojtjen e saj energjike të katolikëve, ishte imponuar edhe kundrejt myslimanëve. Ai i deklaroi zyrtarëve italianë se kishte ardhur në Romë për të hartuar me një jurist të Vatikanit një përkujtesë plotësuese për peticionin e ipeshkvijve shqiptarë. Zyrtarët italianë u treguan të gatshëm për ta mbështetur juristin në fjalë me

²⁴ Fran Kiri, "Kuptimi shkolluer ndër kombe të qytetërueme. Të dhëna dhe statistika rreth historisë, pikëpamjeve dhe organizimit arsimor në Angli, Gjermani, SHBA, Francë, Holandë, Belgjikë dhe Brazil", në *Hylli i Dritës*, nr. 56, Shkodër, maj 1933, f. 201-213.

²⁵ TNA, FO 371/13562. Peticion i argjipeshkvit dhe ipeshkvijve shqiptarë drejtuar LK më 20.5.1933.

²⁶ AMAE, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 32, fasc.13. Telekspres i Zyrës për Shqipërinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme për ambasadën italiane pranë Selisë së Shenjtë, Romë, 14.11.1933.

²⁷ TNA, FO 371/13562. Raport i legatës britanike në Durrës për FO, 27.9.1933.

²⁸ Roberto Morozzo della Rocca, *Nazione e religione in Albania (1920-1944)*, Bologna: il Mulino, 1990, f. 140-141.

²⁹ TNA, FO 371/13562. Raport i përfaqësuesit britanik në LK për FO, 13.10.1933.

dokumente dhe informacione. Por, nga ana tjetër, ata shprehën keqardhje për ndihmën që ipeshkvijtë shqiptarë kishin kërkuar në LK, e mbi të gjitha për mënyrën se si ajo ishte paraqitur pa dëgjuar paraprakisht mendimin e saj. Aq më tepër që Ministria e Jashtme ishte angazhuar për të arritur drejtpërdrejtë nga qeveria shqiptare objektin e ankimimit. Della Pietra pranoi vërejtjet e bëra dhe deklaroi se paraqitja e ankesës kishte ndodhur pasi Episkopati shqiptar, i irrituar prej masave të marra nga qeveria shqiptare, kishte dashur të provonte të gjitha rrugët e mundshme për drejtësi; se pasi kishte vendosur t'i drejtohej për ndihmë LK, në vend të qeverisë italiane, kishte preferuar ta bënte këtë duke shfrytëzuar si ndërmjetës Vatikanin. Ai u justifikua se kjo ishte bërë për t'i lënë Italisë liri më të madhe veprimi. Por, në fakt kjo pasqyronte përpjekjet e klerit për të ndjekur një politikë të pavarur nga Roma.

Zyrtarët italianë e pyetën Della Pietran nëse qeveria shqiptare kishte bërë përpjekje të drejtpërdrejta apo tërthorazi për të zgjidhur problemin e shkollave. Ai u përgjigj negativisht, duke shtuar se kjo çështje mund të zgjidhej në kuadrin e një Konkordati.³⁰ Sipas diplomatëve italianë, Della Pietra, dëshironte që përkujtesa të hartohej nga Farnezina. Por, kjo refuzoi ta bënte një gjë tilla. Ajo ofroi vetëm sqarime rreth impenjimeve të marra nga qeveria shqiptare për pakicat dhe rreth procedurës gjeneviane. Përfaqësuesi i Zyrës për Shqipërinë në MPJ në Romë, ishte i mendimit se Vatikani nuk dëshironte të merrte asnjë qëndrim lidhur me peticionin e ipeshkvijve shqiptarë, duke iu bashkuar pikëpamjes italiane se ajo ishte një përçapje false.

Della Pietra deklaroi në Farnezina se Mark Kodheli i kishte sugjeruar qeverisë së tij të riniste tratativat për përmbylljen e Konkordatit dhe, përmes një rruge të tilla, t'i jepej zgjidhje edhe çështjes së shkollave katolike. Por kjo duhej bërë pa krijuar përshtypjen e kapitullimit përballë Italisë. Sipas Della Pietra-s, në rast se negociatat do të zhvilloheshin, Selia e Shenjtë do të tregohej intransigjente përse i përkiste shkollave dhe të drejtës që priftërinjtë katolikë të ritit grek të shërbenin lirisht në Shqipëri. Por, nga ana tjetër, ajo do të heshte mbi çështjet e martesës civile dhe të divorcit që kishin shkaktuar dështimin e tratativave të nisura disa vite më parë. Ai ishte i mendimit se iniciativa për tratativa të reja

³⁰ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 32, fasc.13. Raport i Zyrës për Shqipërinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë për nënsekretarin e shtetit, Romë, 13.10.1933.

duhej të merrej nga qeveria shqiptare.³¹ Një pretendim ky aspak i justifikuar, nga asnjë parim i së drejtës ndërkombëtare.

Vërejtjet e qeverisë shqiptare lidhur me petitionin e ipeshkvijve katolikë konsistonin në faktin se ajo nuk e konsideronte popullsinë katolike si pakicë, por si pjesë integrale të kombit shqiptar. Ajo i përgjigjej atyre duke ripërsëritur se qëllimi i qeverisë shqiptare ishte të ribashkonte të gjithë shqiptarët e feve të ndryshme nën të njëjtat ligje, për të shfuqizuar rivalitetet shekullore dhe për të konsoliduar shtetin dhe kombin. Ky qëllim, ishte arritur plotësisht. Megjithatë në jetësimin e një vepre të tillë kaq të rëndësishme nuk përjashtohej mundësia që sedra e ndonjëres prej bashkësive fetare mund të ishte lënduar prej humbjes së disa prerogativave të kohës së sundimit osman.³² Qeveria shqiptare kishte hartuar Kodin Civil të ngjashëm me atë francez, zviceran dhe italian, e si rrjedhojë akti i martesës nuk mund të ishte veçse civil, por pa penguar një martesë të mëtejme fetare. Ajo që ndodhte me shkollat, ishte rrjedhojë e aplikimit të ligjit mbi unifikimin e edukimit kombëtar. Përsa i përkiste ligjit mbi bashkësitë fetare, qeveria shqiptare nuk e fshihte habinë e madhe që kishte shkaktuar peticioni, pasi normat e ligjit në fjalë nuk ishin aplikuar për bashkësinë katolike.³³ Për këtë, I Ngarkuari me Punë i Shqipërisë në Londër dhe njëkohësisht përfaqësuesi i Shqipërisë në Asamblenë e LK, Fuad Asllani zhvilloi një bisedë me ministrin italian në Tiranë lidhur me petitionin e paraqitur nga ipeshkvijtë, i cili bazohej mbi “të drejta të pretenduara të një pakice fetare”. Ai i deklaroi ministrit italian mendimin e qeverisë shqiptare se, në rastin konkret, nuk mund të flitej për pakicë, pasi kjo nënkuptonte një kriter diskriminimi. Ndërsa

³¹ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 32, fasc.13. Raport i Zyrës për Shqipërinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme për nënsekretarin e shtetit, Romë, 27.10.1933.

³² Në periudhën e sundimit osman komunitetet fetare gëzonin një autonomi të brendshme për sa i përket institucioneve arsimore, ushtrimit të lirisë së besimit dhe praktikave që kishin të bënin me parimet themelore të së drejtës kishtarë, martesës, etj., të gjitha këto në kuadër të sistemit të mileteve mbi të cilën ishte ndërtuar struktura sociale e Perandorisë Osmane. "Millet", në Bruce Masters, *Encyclopedia of the Ottoman Empire*, Ed. Gábor Ágoston and Bruce Alan Masters, New York: InfoBase Publishing, 2009, f. 383.

³³ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 32, fasc.13. Telekspres i delegacionit italian në Lidhjen e Kombeve për Zyrën për Shqipërinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Politike në Romë dhe për dijeni ambasadës italiane pranë Selisë së Shenjtë, Gjenevë, 3.9.1933.

qeveria shqiptare e trajtonte njëloj popullsinë e saj pavarësisht besimit. Veç kësaj,-ai shtoi,-se cili ishte kriteri themelor që në pikëpamjen fetare i jepte status pakice një pjese të popullsisë kundrejt shtetit të cilit kjo popullsi i përkiste? Diversiteti i religjionit mes këtij dhe vetë shtetit? Por nëse shteti ishte laik, nuk mund të flitej më për pakicë. “Me çfarë të drejte ipeshkvijtë flasin në emër të popullsisë katolike? Ata mundën, të përfaqësojnë vetëm klerin”.

Ministri italian u hoq si i painformuar. Ai i deklaroi Fuad Asllanit se legata italiane nuk kishte pasur dijeni për petitionin e paraqitur nga ipeshkvijtë. Ajo kishte pasur vetëm një informacion të tërthortë shumë kohë pas paraqitjes. Prandaj, duke mos njohur konsideratat që përmbante ky peticion, ministri italian u shpreh se nuk ishte në gjendje të gjykonte vlerën e tyre juridike. Megjithatë, ai nuk hezitoi të pyeste për “kureshti” se çfarë përfundimi do të kishte një apel i tillë. Fuad Asllani iu përgjigj se nuk do të kishte asnjë përfundim. Ai shtoi se qeveria shqiptare, kishte paraqitur në LK një parashtrim me argumente të vlefshme që rrëzonin tërësisht ato mbi të cilat bazohej peticioni. Ndërsa ministri italian e pyeti Fuad Asllanin se çfarë vlere do të kishin këto masa në rast se sipas shtypit rezultonte që shkollat private të sapombyllura nuk ishin zëvendësuar me të tjera shtetërore. Madje, disa prej atyre ekzistuese po mbylleshin, duke detyruar mijëra nxënës të ndërprisnin studimet. Fuad Asllani pranoi se: masa ishte marrë me tepër nxitim; se në të vërtetë shteti nuk ishte në gjendje të merrte përsipër arsimimin e nxënësve të lënë jashtë shkollave të cilave u ishte diktuar mbyllja; se gjendja për momentin ishte tejet e rënduar. Por, ai u përpoq ta zbuste këtë pohim me vlerësimin se programi i ri shkollor ishte i orientuar të reduktonte ndjeshëm numrin e studentëve, pasi ata, sipas tij, përbënin një masë të mbingarkuar nëpunësish për buxhetin e vogël të qeverisë shqiptare.

Ministri italian i rikujtoi Fuad Asllanit deklaratën e paraqitur në LK nga delegati shqiptar në vitin 1921, në të cilën flitej për pakica fetare dhe shtoi se nuk mund të mos njihej një pakicë e tillë për faktin se shteti ishte laik. Kjo për shkak se, edhe atje ku nuk ekzistonte një religjion shtetëror, shteti ushtronte një politikë religjioze prej së cilës një pjesë e popullsisë mund të ndjehej e prekur nëse ajo politikë i sillte dëm më të madh se pjesëve që ushtronin një religjion tjetër. Në optikën e ministrit italian, për të përcaktuar politikën minoritare nuk mjaftonte vetëm kriteri diskriminues. Ai ishte kundër pikëpamjes se për të folur për politikë

minoritare me theks religjioz, lipsej që vetë shteti të ndiqte një religjion të caktuar.

Një deklaratë të ngjashme ministrit italian i bëri edhe ministri i Oborrit Mbretëror, Ekrem Libohova. Pasi përmendi peticionin e ipeshkvijve, ai shtoi se kleri katolik, duke iu drejtuar si pakicë LK, kishte treguar qartë se sa të drejtë kishte qeveria shqiptare për t'i dhënë fund veprimtarisë së tij që edhe nën petkun e mësimdhënies, pengonte unitetin kombëtar.³⁴

Marrëdhëniet e acaruar që u krijuan mes Shqipërisë dhe Vatikanit për shkak të mbylljes së shkollave katolike i shfrytëzoi Italia. Ajo u përpoq të rriste kredibilitetin tek qarqet klerikale dhe të merrte pozitën e protektorese së katolicizmit shqiptar. Një rol të tillë diplomacia dhe politika italiane e kishte ëndërruar që me rënien e Austro-Hungarisë. Kjo vihet re nga fakti se Zyra për Shqipërinë në MPJ në Romë udhëzoi delegacionin e saj në LK se në interes të qeverisë italiane ishte që çështja e shkollave të zvarritej sa më gjatë, në mënyrë që ajo të kishte një zgjidhje “ekstra gjeneviane” e që të dukej si vepër e saj. Në rast se në LK do të mbërrihej në një zgjidhje, ajo dëshironte që të ishte e pjesshme dhe në favor të klerit katolik shqiptar.³⁵

Delegacioni italian në Gjenevë ndërhyri në Sekretariatit e LK, konkretisht tek Azcarate, i cili drejtonte Seksionin për minorancat, që anëtar i ri në Komitetin që do të shqyrtonte peticionin e ipeshkvijve shqiptarë, të ishte në favor të Kishës Katolike.³⁶ Ndërsa Etërit Jezuitë në Shqipëri ishin skeptikë. Në Selinë e Shenjtë kishte mbërritur lajmi se ata mendonin që tashmë nuk kishte më asnjë shpresë për rihapjen e shkollave katolike.³⁷

³⁴ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 32, fasc.13. Telekspres i legatës italiane në Tiranë për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Tiranë, 21.10.1933.

³⁵ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 32, fasc.13. Telekspres i Zyrës për Shqipërinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme për delegacionin italian në Lidhjen e Kombeve dhe për dijeni ambasadës italiane pranë Selisë së Shenjtë, Romë, 24.10.1933.

³⁶ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 32, fasc.13. Telekspres i kryetarit të delegacionit italian në Lidhjen e Kombeve, R.Bova Scopa për Zyrën për Shqipërinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe për dijeni ambasadës italiane pranë Selisë së Shenjtë, Gjenevë, 8.12.1933.

³⁷ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 32, fasc.13. Telekspres i Zyrës për Shqipërinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme për legatën italiane në Tiranë, Romë, 23.12.1933.

Qeveria italiane e udhëzoi delegacionin e saj në Gjenevë se diskutimi që ai duhej të mbante në Këshillin e LK për çështjen e shkollave minoritare në Shqipëri duhej të ishte në favor të klerit katolik.³⁸ Kjo i ndezi shpresat e qarqeve klerikale. Zyra famullitare e Tiranës ishte e mendimit se, nëse sigurohej mbështetja dhe presioni i Italisë ndaj qeverisë shqiptare, çështja e shkollave katolike do të zgjidhej në përputhje me interesat e kishës, pa nënshkruar asnjë Konkordat, një qasje kjo tejet pragmatiste dhe që tregonte se jo të gjitha segmentet klerikale e dëshironin arritjen e Konkordatit.

Më 28 dhjetor 1934, në ambasadën italiane në Vatikan u zhvillua një takim mes Zef Serreqit, Adjutant i Parë i Oborrit Mbretëror, Mark Kodhelit, i Ngarkuar me Punë i Shqipërisë në Romë, markezit Talamo Atenolfi, Këshilltar i Ambasadës Mbretërore të Italisë në Vatikan, Dr. Kastelani-t, Sekretar i Zyrës për Shqipërinë në MPJ në Romë dhe imzot Piccardo-s për përmylljen e një Konkordati mes Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë. Anëtarët e delegacionit shqiptar deklaruan se qeveria shqiptare ishte motivuar të niste tratatativa të drejtpërdrejta me Selinë e Shenjtë për nënshkrimin e një Konkordati shpeshherë edhe nga dëshira e qeverisë italiane për të rregulluar çështjet e ndryshme që ekzistonin mes Selisë së Shenjtë dhe Shqipërisë. Zef Serreqi shkëmbeu pikëpamjet me imzot Piccardo-n duke ofruar nga ana e qeverisë shqiptare nënshkrimin e një Konkordati të përgjithshëm, i cili të mos përmbante asnjë shënim për çështjet me karakter të posaçëm. Ai sugjeroi që të mbahej parasysh se, qeveria shqiptare, do të ishte e gatshme për të dhënë liri të plotë dhe barazi për ritin *uniat*; për të lejuar që nxënësit laikë të frekuentonin pa detyrim të rrobës kishtarë, shkollat e seminareve (një e drejtë e tillë nuk mund të konsakrohej zyrtarisht në Konkordat, ngaqë ishte në kundërshtim me dispozitat e Statutit Themeltar). Zef Serreqi kërkoi me ngulm një përgjigje nga Vatikani. Por, pas disa ditësh, u thërrit nga imzot Piccardo, i cili i deklaroi se propozimet shqiptare ishin shqyrtuar nga Kongregacioni kompetent dhe se nuk ishin gjykuar të mjaftueshme për t'u marrë si bazë diskutimi. Sipas tij, në asnjë Konkordat të Selisë së Shenjtë nuk ishte shmangur trajtimi i çështjes shkollore. Zef Serreqi iu

³⁸ AMAE, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 60, fasc.6. Telekspres i Zyrës për Shqipërinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë për legatën italiane në Tiranë dhe për dijeni ambasadës italiane pranë Selisë së Shenjtë, Romë, 14.1.1935.

përgjigj duke thënë se propozimet nuk ishin fjala e fundit e qeverisë shqiptare dhe priste që Selia e Shenjtë të bënte kundërpropozimet. Pas disa ditësh, Zef Serreqi u thirr përsëri në Vatikan nga Kardinali Sekretar i Shtetit i cili, në prani të imzot Piccardo-s, i dorëzoi kundërpropozimet e Selisë së Shenjtë. Serreqi deklaroi se nuk kishte tagrin për të diskutuar këto kundërpropozime, por shtoi, si mendim personal, se në to Selia e Shenjtë kërkonte shumë më tepër se ajo çka kishte pasur deri tani në Shqipëri; se nuk ishin mbajtur parasysh dispozitat statutoare shqiptare me të cilat nuk mund të pajtohej një akt ndërkombëtar që pranonte një shmangie prej parimeve themelore të politikës arsimore shqiptare; se aktualisht në të gjithë Shqipërinë gjendeshin vetëm tre gjimnaze (Tiranë, Shkodër, Korçë); me propozimin e Selisë së Shenjtë do të hapeshin praktikisht edhe dy të tjerë në Shkodër; gjë që nënkuptonte, përveçse një shpërpjesëtim të ndjeshëm mes rajoneve, edhe një rrezik, duke pasur parasysh se numri i nxënësve me arsim të mesëm në Shqipëri ishte më i lartë se nevojat e vendit; shtimi i numrit të gjimnazeve do të thoshte të prodhohej një pafundësi të papunësh. Prandaj, ajo për të cilën Shqipëria kishte nevojë, nuk ishin shkollat letrare, por ato profesionale.

Kjo e shtyu imzot Piccardo-n që të ndryshonte “pistë”. Ai e hodhi fjalën për mundësinë e zëvendësimit të dy liceve të Shkodrës me shkolla bujqësore. Dy ditë pas këtyre bisedimeve, Zef Serreqi, si personi i autorizuar nga MPJ, mori projektpropozimin e Vatikanit me ftesën për të bërë ç’ ishte e mundur që ai të pranohej nga qeveria shqiptare dhe me sigurimin se ai kishte edhe miratimin e qeverisë italiane. Ai u nis menjëherë drejt Tiranës dhe, jo pa vështirësi, bëri të mundur që ky projekt të pranohej edhe nga Mbreti. Por, kur Zef Serreqi u paraqit në Vatikan, mori përgjigje se i njëjti projekt ishte i papranueshëm, ngaqë Selia e Shenjtë nuk mundej në asnjë mënyrë t’i shmangej asaj që përmbahej integralisht në paragrafin e parë të kundërpropozimeve, domethënë nga frekuentimi i studentëve laikë në seminarët që ishte konsideruar minimumi i domosdoshëm. Ndërsa, përsa i përkiste shkollave bujqësore, ato ishin mbi të gjitha në interes të qeverisë shqiptare. Prandaj, tratativat ngecën në këtë pikë. Kjo e detyroi Zef Serreqin të deklaronte se propozimet që përmbante projekti ishin koncesioni i fundit i qeverisë shqiptare. Ajo ishte përherë e gatshme që, mbi këtë bazë, të binte në ujdë qoftë drejtpërdrejtë me Selinë e Shenjtë qoftë ndërmjet qeverisë italiane. Megjithatë, ai theksoi se qeveria

shqiptare nuk mund të pranonte që çështja shkollore të merrte zgjidhje të veçantë, por në kuadër të përmbylljes së Konkordatit.³⁹

Tratativat e qeverisë shqiptare me Selinë e Shenjtë për ta zgjidhur çështjen e shkollave katolike u shoqëruan me një sërë propozimesh dhe kundërpropozimesh. Kjo tregon predispozitën e të dyja palëve për të arritur në një ujdi të përbashkët. Zyra për Shqipërinë në MPJ të Romës ishte e mendimit se, nëse qeveria shqiptare dëshironte të arrinte në një marrëveshje me Selinë e Shenjtë, duhej t'u jepte laikëve të drejtën për të frekuentuar seminarët dhe të njihite vlefshmërinë e diplomave të lëshuara nga këto institucione. Gjithashtu ajo duhej të lejonte krijimin e jetimoreve me të drejtën për të hapur shkolla për djem e vajza për të jashtëm. Ndërsa propozimi për të hapur shkolla bujqësore mund të mbahej në rast se shihej një avantazh nga pala shqiptare. Por, kjo nuk ishte esenciale për të siguruar suksesin e negociatave me Selinë e Shenjtë.

Për shkak të reformës arsimore, në Shkodër ishin mbyllur tre shkolla të Etrëve Jezuitë, shkolla e Françeskanëve dhe e Murgeshave. Në qytetet e tjera shqiptare urdhrat fetarë katolikë nuk kishin shkolla. Qeveria shqiptare pranonte se Shqipëria nuk mundej, për arsye të njohura, të rihapte shkollat e sipërthëna. Por, ajo sugjeronte se mund të kërkohej si kompensim përmbyllja e menjëhershme e Konkordatit me shtesat e mëposhtme: pranimi nga ana e qeverisë shqiptare i pikëpamjes të Selisë së Shenjtë rreth kishave të ritit uniat; ngritja dhe administrimi nga ana e urdhrave fetarë i azileve; mësim fetar i detyrueshëm dhe intensiv në shkollat shtetërore i bërë nga fetarët; angazhim nga ana e qeverisë shqiptare që në shkolla nuk do të bëhej në asnjë formë propagandë antifetare; frekuentim i Seminarëve prej laikëve; ngritja e jetimoreve për djem e për vajza në Tiranë, Shkodër dhe, eventualisht, në qytete të tjera shqiptare.⁴⁰ Këto pika tregonin se lëshimet e qeverisë shqiptare ishin të konsiderueshme. Madje, në disa drejtime, ato binin ndesh me reformat emancipuese dhe laicizuese të sistemit arsimor shqiptar. Interesi i Shqipërisë për të nënshkruar një Konkordat me

³⁹ AMAE, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 60, fasc.6. Telekspres i legatës italiane në Tiranë për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Tiranë, 14.1.1935.

⁴⁰ AMAE, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 60, fasc.6. Raport i Zyrës për Shqipërinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme për nënsekretarin e shtetit, Romë, 17.1.1935.

Vatikanin ishte tepër i madh. Ai do t'i fuste katolikët shqiptarë në vathën kombëtare, duke vendosur paqen sociale mes tyre dhe qeverisë.

Ndërsa kundërpropozimi i Selisë së Shenjtë për qeverinë shqiptare përmbante këto elementë: Kisha Katolike të ishte e lirë të hapte dhe të mbante Seminaret Jezuite dhe Françeskane, dhe në shkollat e këtyre instituteve të pranoheshin nxënës të jashtëm, pa u detyruar të vishnin rrobën kishtarë; gjuha kryesore e këtyre instituteve dhe shkollave, përjashtuar kurset filozofike dhe teologjike, do të ishte shqipja; mësimi dhe rregulli disiplinor do të vareshin ekskluzivisht nga Autoriteti Kishtar; diplomat që do u jepeshin nxënësve të cilët do të jepnin një provim në përputhje me programet e shkollave mbretërore, me pjesëmarrjen e një përfaqësuesi të qeverisë, me kërkesë të drejtuesve të institutit, do të kishin të njëjtën vlerë, me të gjitha rrjedhojat, me diplomat e lëshuara nga shkollat shtetërore; Rregulltarët e çfarëdo Urdhri dhe Kongregacioni, do të kishin të drejtë të hapnin strehët varfërore, me shkolla përkatëse, për të rinjtë aspirantë për statusin fetar dhe për formimin e tyre të mëtejshëm. Në këto strehë dhe shkolla të aplikoheshin dispozitat e paragrafit të mëparshëm. E njëjta e drejtë e cila në paragrafin 2 i ishte njohur Rregulltarëve të cilitdo Urdhër dhe Kongregacioni, strehëve dhe shkollave për të cilat do të aplikoheshin dispozitat e paragrafit 1 do t'u njihej edhe institucioneve të bamirësisë, si jetimoret, strehët femërore etj., që vareshin nga Ente Religjioze Katolike të cilat mund të hapnin shkolla, ku do të kishin hyrje të lirë edhe nxënësit e jashtëm, dhe do të aplikoheshin dispozitat e paragrafit 1.⁴¹

Kjo e detyroi qeverinë shqiptare të riformulonte propozimin e saj, sipas të cilit, Kisha Katolike do të ishte e lirë të hapte dhe të mbante Seminaret Jezuite dhe Françeskane. Gjuha e këtyre instituteve, përjashtuar kurset filozofike dhe teologjike, do të ishte shqipja. Mësimi dhe rregulli disiplinor do të vareshin ekskluzivisht nga autoritetet kishtarë. Rregulltarët e cilitdo Urdhër dhe Kongregacioni do të kishin të drejtën të hapnin strehët, me shkollat përkatëse, për të rinjtë aspirantë për statusin fetar dhe për formimin e tyre të mëtejshëm. Lejohej ngritja e strehëve femërore dhe e jetimoreve në varësi të drejtpërdrejtë të Enteve Religjioze Katolike. Ndërsa jetimoreve brenda disa caqeve i lejohej e drejta për të hapur shkolla. Në këto shkolla, për të cilat duhej të

⁴¹ *Po aty*. Kundërpropozimi i Selisë së Shenjtë drejtuar qeverisë shqiptare mban datën 20 dhjetor 1934.

saktësohej natyra dhe numri, do të ishin të zbatueshme dispozitat që do vendoseshin me marrëveshje të përbashkët.⁴²

Zyra për Shqipërinë në MPJ në Romë ishte e mendimit se kundërpropozimi i Selisë së Shenjtë duhej të ishte baza e vetme e mundshme për një marrëveshje. Mund të pranohej vetëm heqja e plotë ose e pjesshme e paragrafit 4 (vepra bamirësie, strehë fëmimore, jetimore); ngaqë institucionet e parashikuara në të përfaqësonin për Selinë e Shenjtë dhe për qeverinë italiane një interes më të ulët se ato të parashikuara në tre paragrafët e parë. Përsa i përkiste arsimit fillor, duhej të mbahej parasysh se ai mund të jepej edhe në seminarët dhe në institutet e tjera të përgatitjes fetare.⁴³

Farnezina njoftoi Vatikanin se qeveria italiane ishte e gatshme të ushtronte trysni mbi qeverinë shqiptare për të marrë në shqyrtim kundërpropozimet e fundit të Selisë së Shenjtë. Por MPJ dëshironte të dinte, përmes një promemorie zyrtare të Sekretarisë së Shtetit, se, nëse merreshin si bazë e marrëveshjes propozimet që përmbante projekti i 20 dhjetorit 1934, Selia e Shenjtë do të ishte e gatshme të pranonte: a) një klauzolë që kufizonte në dy numrin e seminareve dhe të instituteve të edukimit fetar për djem, dhe po ashtu për institutet e edukimit fetar për vajza; b) një klauzolë që parashkruante se të dy institutet e sipërthëna nuk mund të kishin seli në të njëjtin qytet; c) heqjen e paragrafit 4 të projektit në të cilin bëhej fjalë për vepra bamirësie, jetimore dhe strehë fëmimore.⁴⁴ Deri tani nuk kemi arritur të zbulojmë se cila ishte përgjigjja e Vatikanit. Ndoshta, Sekretaria e Shtetit nuk dëshironte që politika italiane të merrte haptazi rolin e protektores së katolicizmit shqiptar. Kjo edhe për shkak të marrëdhënieve plot ulje e ngritje që qeveria italiane dhe Partia Fashiste kishte me Vatikanin.

Gjithsesi, ndërhyrja e qeverisë italiane lidhur me këtë çështje filloi të bëhej gjithnjë e më e evidente. Musolini i deklaroi Zef Serreqit se në rast se tratativat me Selinë e Shenjtë do të kishin vështirësi dhe vonesa të

⁴² *Po aty*. Kundërpropozimi i qeverisë shqiptare drejtuar Selisë së Shenjtë mban datën 28 janar 1935.

⁴³ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 60, fasc.6. Telekspres i Zyrës për Shqipërinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë për të Ngarkuarin me Punë pranë Selisë së Shenjtë, Romë, 29.1.1935.

⁴⁴ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 60, fasc.6. Telekspres i Zyrës për Shqipërinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme për të Ngarkuarin me Punë pranë Selisë së Shenjtë, Romë, 31.1.1935.

mëtejme, ai kishte ndërmend që çështja shkollore të merrte zgjidhje të drejtpërdrejtë mes Italisë dhe Shqipërisë. Serreqi vlerësoi rolin e Italisë si ndërmjetëse mes Shqipërisë dhe Vatikanit duke theksuar se, në negociatat e zhvilluara nga ai në Vatikan, qeveria italiane kishte bërë ç' ishte e mundur për të bindur Selinë e Shenjtë të përmbushte propozimet shqiptare. Kështu, i detyrohej mbi të gjitha trysnisë italiane që Selia e Shenjtë kishte pranuar të hiqte dorë prej qëndrimeve të saj fillestare, duke u mjaftuar me një zgjidhje të kufizuar, siç ishte lejimi i studentëve laikë që të frekuentonin seminarët pa detyrimin e rrobës kishtarë. Megjithatë, sipas Zef Serreqit, ishte e nevojshme që edhe pala shqiptare të tërhiqej nga ndonjë qëndrim i papajtuëshëm që pengonte përmbylljen e shpejtë të negociatave. Në rast se nuk do të ishte e mundur të arrihej drejtpërdrejtë në një marrëveshje mes Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë, çështja shkollore do të kthehej në interes të drejtpërdrejtë të qeverisë italiane, e cila nuk kishte arsye për të modifikuar pikëpamjen e saj të mëparshme.⁴⁵

Bisedimet e palës shqiptare me Selinë e Shenjtë nuk patën asnjë rezultat. Kjo e detyroi Zef Serreqin t'i drejtohej për ndihmë qeverisë italiane.⁴⁶ Sekretaria e Shtetit njoftoi ambasadën italiane pranë Selisë së Shenjtë se bisedimet e zhvilluara me Zef Serreqin, kishin dështuar dhe se në Vatikan ishin të shqetësuar prej një relacioni të detajuar të paraqitur nga ipeshkvi i Lezhës, imzot Bumçi për gjendjen e krijuar në Shqipëri. Sipas tij, disa qarqe të autorizuara të qeverisë shqiptare kishin konfirmuar faktin se çështja e shkollave nuk do të kishte zgjidhje tjetër nga ajo e përcaktuar në ligjet përkatëse. Edhe nëse qeveria shqiptare do të ishte e shtrënguar të pranonte ndonjë transaksion, praktikisht ky nuk do të aplikohet asnjëherë. Sekretaria e Shtetit mendonte se qeveria shqiptare ishte e vendosur të mos bënte asnjë lëshim. Prandaj, duke u nisur nga këto predispozita nuk mund të arrihej në një zgjidhje të pranueshme.⁴⁷

⁴⁵ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 60, fasc.6. Telekspres i Zyrës për Shqipërinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë për legatën italiane në Tiranë, Romë, 5.2.1935.

⁴⁶ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 60, fasc.6. Letër e Giuseppe Piccardo për të Ngarkuarin me Punë të Italisë pranë Selisë së Shenjtë Markeze Talamo Atenolfi, Vatikan, 14.2.1935.

⁴⁷ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 60, fasc.6. Telekspres i ambasadës italiane pranë Selisë së Shenjtë për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Vatikan, 15.2.1935.

Një pikëpamje e tillë nuk pasqyronte realisht dëshirën e qeverisë shqiptare. Ajo ishte përpjekur të bënte lëshime maksimale ndaj Vatikanit. Por përsëri tratativat ngecën. Prandaj ajo e pa të arsyeshme të ngarkonte ministrin italian në Tiranë që të merrte rolin e ndërmjetësit lidhur me çështjen e shkollave katolike. Zyra për Shqipërinë në Farnezina informoi ambasadën në Vatikan se, për këtë problem, do të mbaheshin parasysh kërkesat e Selisë së Shenjtë.⁴⁸

Në LK çështja e shkollave private u shqyrtua me seriozitet të plotë, duke kaluar të gjitha hallkat institucionale. Meqenëse kjo çështje kishte karakter juridik, Këshilli i LK më 21 janar 1935 ia përcolli ankesën greke, e cila kishte ngritur e para pretendimet ndaj shtetit shqiptar, në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës.⁴⁹ Në muajin mars filloi një proces gjyqësor përpara të cilit të dyja palët paraqitën ankesat e tyre. Megjithatë, në fillim të prillit 1935, Gjykata e Hagës me 8 vota pro dhe 3 vota kundër duke përfshirë edhe kryetarin e gjyqit anglezin Sesil J. B. Hurst me anëtarët Demetre Negulesku (rumun) dhe Kont M. Rostworoski (polak), i dha të drejtë Greqisë. Si përfundim, LK plotësoi kërkesën greke për rihapjen e shkollave private të minoritetit grek në Shqipëri. Por ajo nuk mori asnjë masë për të zbatuar të drejtën për shkollimin në gjuhën amtare as për popullsinë shqiptare njëmilionëshe në Kosovë dhe as për mijërat e shqiptarëve në Çamëri që banonin në trojet e tyre.⁵⁰

Presioni i Shqipërisë dhe i Mbretit Zog duke ndjekur një politikë të tillë, pavarësisht verdiktit të dhënë në favor të Greqisë pati efektet e veta. Kjo politikë justifikohet edhe me faktin se një shtet i sapolindur, i paqytetëruar, i pa kulturë, i helmuar gjer në rrënjë nga propagandat e huaja, i vogël dhe mozaik religjionesh e kishte më se të nevojshme një reformë të tillë. Shkolla shqiptare nuk ishte dhe nuk duhet të ishte vetëm një institucion ku mësoheshin shkencat, por edhe një instrument për t'i bashkuar kombëtarisht shqiptarët. Vetëm shkollat shtetërore, të cilat qëndronin mbi religjionet mund të intoksikonin shoqërinë shqiptare nga

⁴⁸ AMAE, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 60, fasc.6. Telekspres i Zyrës për Shqipërinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë për ambasadën italiane pranë Selisë së Shenjtë, Romë, 22.3.1935.

⁴⁹ Më gjerësisht ky problem është trajtuar në artikullin e Beqir Metës, "Diskutimet shqiptaro-britanike për çështjen e shkollave të minoritetit grek gjatë vitit 1935", në *Studime historike*, nr.1-2, Tiranë: 2017, f. 215-241.

⁵⁰ Iliaz Gogaj, *Mirash Ivanaj - Personalitet i shquar i universit shqiptar*, Tiranë: Botime Erik, 2004, f.174.

propagandat dhe ndasitë.⁵¹ Autoritetet shtetërore e mohonin se një aksion i tillë ndërmerrej për t'i vënë fre ekspansionit dhe hegjemonisë kulturore italiane mbi popullin shqiptar. Ato e justifikonin këtë veprim me synimin për të edukuar breza të shëndoshë të pajisur me edukatë patriotike.⁵² Prandaj reforma arsimore e ndërmarrë nga shteti shqiptar nuk kishte asnjë arsye të drejtohej kundër shkollave të klerit katolik.

Ipeshkvijtë katolikë, të mbledhur për funeralin e argjipeshkvit Mjeda, u takuan në selinë e delegatit apostolik, Della Pietra. Ai u komunikoi atyre se vendimi i Gjykatës së Hagës, i bazuar mbi deklaratat e qeverisë shqiptare të vitit 1921 që përmendte pakicat e racës, të gjuhës dhe të fesë, nuk do të shtrihej për pakicat katolike dhe për shkollat e saj. Kjo gjykatë nuk kishte marrë në shqyrtim peticionin e paraqitur nga ipeshkvijtë në vitin 1933. Delegati apostolik u kujtoi se përgjegjësia i atribuohet ipeshkvijve që nuk kishin ndjekur këshillat e qeverisë italiane e cila, me anë të legatës, u sugjeroi atyre që të dërgonin një përkujtesë plotësuese të hartuar nga një jurist i mirë ndërkombëtar, duke ofruar edhe mbështetjen e saj. Më 15 korrik 1935, Della Pietra i drejtoi konsullit italian në Shkodër një letër ku i bënte të ditur se ipeshkvijtë dëshironin të paraqisnin me shkrim një përkujtesë plotësuese lidhur me letrën e drejtuar më parë Këshillit të LK për rihapjen e shkollave katolike. Por, para se të hartonin një akt të tillë, Ipeshkvijtë kërkonin të dinin nëse qeveria italiane të cilës i detyroheshin dhe i shprehnin mirënjohjen e thellë për të gjitha favoret që kishin pasur deri tani, do të denjonte të paraqiste si të sajën ankesën e tyre para LK dhe ta mbështeste me influencën e saj të fuqishme, duke ditur se ndryshe ankimimi i projektuar do të ishte i kotë dhe i paefektshëm. Në rast se qeveria italiane nuk e merrte përsipër këtë, ipeshkvijtë kërkonin udhëzime se cila ishte rruga që duhej ndjekur për të arritur qëllimin.⁵³

Por, qeveria italiane nuk pranoi të hartonte peticionin e ipeshkvijve shqiptarë. Ajo ishte e bindur se nuk ishte në traditën gjeneviane që një qeveri, e cila nuk figuronte drejtpërdrejtë e interesuar, të bënte një

⁵¹ "Politika arsimore. Mbi ligjin për shtetëzimin e shkollave dhe organizimin arsimor", në *Demokratia*, nr.468, Gjirokastër, 21.7.1935, f. 1.

⁵² *TNA*, FO 371/16624. Raport i legatës britanike në Durrës për FO, 1.11.1933.

⁵³ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 60, fasc.6. Telekspres i konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Salvatore Meloni për legatën italiane në Tiranë, Shkodër, 16.7.1935.

peticion pakicash. Megjithatë, qeveria italiane, theksonte se kurdoherë kishte mbajtur një qëndrim në interes të shkollave klerikale.⁵⁴

Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare e detyroi qeverinë shqiptare të moderonte politikën e saj kundrejt shkollave minoritare. Më 2 nëntor 1935, Mbreti Zog dekretoi “Rregulloren mbi shkollat private të minoriteteve”⁵⁵ të hartuar nga Ministria e Arsimit në të cilën theksohej qartë se Shqipëria do të respektonte deklaratën e saj, të 2 tetorit 1921. Në bazë të kësaj rregulloreje, kërkesa për hapjen e një shkolle private minoritare bëhej prej pleqësisë së vendit dhe i drejtohej Ministrisë së Arsimit me anë të prefekturës.⁵⁶

Kjo kthesë e detyroi ministrin e Arsimit, Mirash Ivanaj të jepte dorëheqjen,⁵⁷ e cila zyrtarisht u shpall se u bë për arsye teknike. Megjithatë, ky personalitet u vlerësua si kandidatura e vetme e më kompetente, e cila përputhej me lartësinë e funksionit të ministrit të Arsimit. Ai vlerësohej dhe gëzonte një respekt të padiskutueshëm nga bota intelektuale e kohës.⁵⁸ Kontributi i tij në historinë e arsimit shqiptar ishte dhe mbetet emblematik ende dhe sot e kësaj dite.

Kleri katolik në Shkodër filloi të rihapte disa shkolla, ndonëse i përmbahej parimit se rihapja e plotë e tyre nuk mund të bëhej veçse me

⁵⁴ *AMAE*, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 60, fasc.6. Telekspres i Zyrës për Shqipërinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë për legatën italiane në Tiranë dhe për dijeni ambasadës italiane pranë Selisë së Shenjtë, Romë, 2.8.1935.

⁵⁵ “Rregullore mbi shkollat private të minoriteteve”, në *Fletore Zyrtare*, nr. 58, Tiranë, 12.11.1935, f. 1-2.

⁵⁶ *Rregullore mbi shkollat private të minoriteteve*, Tiranë: Shtypshkronja e Ministrisë së Arsimit, 1935, f. 4.

⁵⁷ “Për ministrin e ri të arsimit. Mirash Ivanaj. Masat për drejtimin e politikës arsimore në Shqipëri”, në *Demokratia*, nr. 366, Gjirokastër, 14.1.1933, f. 1; “Vepra e Mirash Ivanajt. Në fushën e arsimit”, në *Kuvendi kombëtar*, nr. 5, Bukuresht, 14.1.1934, f. 1; “Shqiptari të edukohet shqiptarisht. Mendime mbi edukimin e brezit të ri nga shteti me ndjenja kombëtare”, në *Djersa e popullit*, nr.12, Tiranë, 30.9.1934, f. 2.

⁵⁸ “Dr. Mirash Ivanaj. Mbi dorëheqjen e tij si ministër i Arsimit”, në *Demokratia*, nr.477, Gjirokastër, 15.9.1935, f. 2; “Pse pat dhënë dorëheqjen Dr.Ivanaj?. Lidhur me problemin e shtetëzimit të shkollave”, në *Arbënia*, nr.129, Tiranë, 28.11.1935, f.1, 6.

autorizim nga ana qeverisë.⁵⁹ Gjithsesi miratimi i dekretligjit për funksionimin e shkollave private krijoi rrethana lehtësuese për klerin, megjithëse kriteret për hapjen dhe mbajtjen e këtyre shkollave tani konsideroheshin më strikte.⁶⁰ Mbreti Zog dhe përfaqësues të lartë të shtetit deklaruan në shtyp se politika e qeverisë shqiptare ndaj shkollave private dhe të minoriteteve kishte pësuar ndryshime rrënjësore.

Për të verifikuar vërtetësinë e deklaratave të Mbretit Zog se shkollat katolike kishin rinisur funksionimin e tyre normal ministri italian në Tiranë, M. Indeli kërkoi sqarime verbale nga konsulli i Shkodrës, Salvatore Meloni. Ky i fundit konfirmoi se: efektivisht mbikëqyrja në lidhje me frekuentimin e nxënësve laikë, në shkollat katolike të Shkodrës kishte ardhur duke u pakësuar, duke lehtësuar punën e urdhrave fetarë; nuk ishte e saktë se qeveria e Tiranës nuk u kishte dhënë udhëzime autoriteteve të Shkodrës. Madje, vetë komandanti i Xhandarmërisë, në funksionin e përkohshëm të prefektit, e dërgonte vajzën e tij në shkollën e murgeshave; nëse numri i nxënësve nuk ishte ende i konsiderueshëm, kjo i detyrohej hezitimit të disa familjeve, veçanërisht të nëpunësve shtetërorë, që nuk ishin të bindur ende krejtësisht për predispozitat reale të qeverisë shqiptare; nëse françeskanët nuk e kishin rihapur ende shkollën e tyre, kjo vinte për shkak se ata e bënë këtë për bindje e solidaritet ndaj rezistencës së ipeshkvijve, të cilët do të kërkonin, për rihapjen e shkollave, një njoftim qeveritar të qartë dhe eksplicit, drejtuar atyre. Ndërsa, Fishta do të shkonte në Romë enkas për të bindur Selinë e Shenjtë, të urdhëronte ipeshkvijtë që të hiqnin dorë nga një rezistencë e tillë.⁶¹ Kjo tregon se situata po vinte duke u normalizuar.

⁵⁹ AMAE, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 60, fasc.6. Telekspres i konsullit të përgjithshëm italian në Shkodër, Salvatore Meloni për legatën italiane në Tiranë, Shkodër, 21.11.1935.

⁶⁰ “Dekret-ligja mbi funksionimin e shkollave”, në *Fletorja zyrtare*, nr. 29, Tiranë, 9.5.1936, f. 3-4; “Dekret-ligja mbi funksionimin e shkollave (Çështja e shkollave private dhe konditat e parapame për to). Nenet e dekret-ligjit”, në *Besa*, nr.1456, Tiranë, 20.5.1936, f. 1, 4; “Dekret-ligja mbi funksionimin e shkollave. (Konditat që duhen plotësuar për çeljen e një shkolle private)”, në *Arbënia*, nr. 264, Tiranë, 20.5.1936, f. 1.

⁶¹ AMAE, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 60, fasc.6. Telekspres i legatës italiane në Tiranë për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, Tiranë, 14.12.1935.

Më 16 dhjetor, legata italiane në Tiranë njoftoi MPJ në Romë mbi nisjen e ministrit të Jashtëm Fuad Asllani për në Gjenevë, për të marrë pjesë në mbledhjen e ardhshme të Këshillit të LK që do të shqyrtonte çështjen e shkollave katolike. Ai do të deklaronte në Gjenevë se rregullimi formal i kësaj çështjeje priste përfundimin e negociatave që pala shqiptare po zhvillonte me Selinë e Shenjtë. Megjithatë, ministri shqiptar do të akordohej edhe me delegacionin italian, duke u mbështetur në këshillat dhe përkrahjen e tij për zgjidhjen e këtij problemi. Qeveria italiane u përpoq ta mbështeste palën shqiptare. Ajo synonte që çështja e shkollave të merrte një zgjidhje të favorshme, duke kënaqur si Shqipërinë ashtu edhe Vatikanin. Nënsekretari i shtetit udhëzoi delegacionin italian në LK që të deklaronte, në mirëkuptim paraprak me delegacionin shqiptar, se: qeveria italiane, merrte parasysht vullnetin e mirë të shfaqur nga qeveria shqiptare në adoptimin në masë të gjerë të tekstit të ri të “Rregullores së shkollave minoritare”, të amendamenteve të sugjeruara nga Këshilli i LK, dhe shprehte besimin se ajo do të adoptonte në tratativat me Selinë e Shenjtë të njëjtën frymë që e kishte përshkuar në zgjidhjen që i kishte dhënë çështjeve të shkollave të pakicave gjuhësore.⁶²

Sidoqoftë tensioni mes Shqipërisë dhe Vatikanit për shkak të mbylljes së shkollave klerikale erdhi duke u normalizuar. Ndërsa një pjesë e këtyre shkollave iu rikthye funksionimit të mëparshëm.

S u m m a r y

EDUCATION REFORM OF 1933: THE CLOSING OF PRIVATE SCHOOLS AND THE FLUSTER OF RELATIONS WITH THE CATHOLIC CLERGY AND THE VATICAN

A new conflict between the Albanian government and the Catholic clergy began when King Zog took a series of measures, which reaffirmed the independence path and were at the same time a measure against the Italian coercive policy. This culminated in April 1933 when Parliament approved the

⁶² AMAE, Fondi: Serie Politica 1931-1945, Albania, Pacco 71, fasc.1. Telekspres i Zyrës për Shqipërinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme për delegacionin italian në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë dhe për dijani edhe ambasadës italiane pranë Selisë së Shenjtë, Romë, 18.1.1935.

amendment of some articles of the Constitution, which prohibited the operation of private schools and turned them into state monopoly. This initiative found approval of intellectuals, teachers and the press of the time. Clergy and Catholic Church had already expressed their opposing stance. Therefore they considered the reform as a direct attack to Catholicism. On April 30, 1933, clergy sent the government a memorandum expressing concern about the law on the closure of private schools which had shocked deeply the conscience of Albanian Catholics.

The closing of Catholic schools along with protests against the government and parliament was accompanied by an internal pastoral of bishops. In this pastoral were tackled specifically the reasons for which the education of youth was responsibility of the parents and the church. After sending the memorandum to the government, Council of bishops decided that in all parishes of the country was to be conducted the public reading of the pastoral. This caused in some parishes, critical comments for the government. Therefore, the latter, in an urgent meeting of the Council of Ministers discussed about this new offensive of the clergy, in order to take the necessary measures. The Albanian government decided to pursue an indifference policy toward such manifestations, while notifying the Archbishop of Shkodra and other bishops as well as all other archbishops, that if other critical gestures would take place, serious sanctions would take place against them.

Catholic clergy sent to League of Nations a memorandum that demanded the Albanian government recognize the rights of minorities. But this was opposed by the representatives of the Albanian state on the grounds that the Albanian Catholics were not a national minority, but an integral part of the Albanian people. However, closing of Catholic schools caused tension between Albania and the Vatican.